

LIGJ
Nr. 9264, datë 29.7. 2004

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT NR.12 TË KONVENTËS “PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli nr.12 i Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4293, datë 2.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PROTOKOLLI NR.12 I KONVENTËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
DHE LIRIVE THEMELORE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës nënshkruese,
duke pasur parasysh parimin themelor, sipas të cilit të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë mbrojtje të barabartë nga ligji,

të vendosur për të ndërmarrë hapa të mëtijshme për të nxitur barazinë e të gjithë personave nëpërmjet zbatimit kolektiv të ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit me anë të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950 (më tutje do të quhet “Konventa”),

duke ritheksuar se parimin i mosdiskriminimit nuk u ndalon shteteve anëtare të marrin masa për të nxitur barazinë e plotë dhe të efektshme, me kusht që për këto masa të ketë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Ndalimi i diskriminimit në përgjithësi

1. Gëzimi i çdo të drejte të saksionuar me ligj sigurohet pa bërë dallim për ndonjë shkak të caktuar, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, pikëpamja politike ose të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, lidhja me një minoritet kombëtar, pasuri, prejardhje ose ndonjë status tjetër.

2. Askush nuk diskriminohet nga ndonjë autoritet publik për ndonjë nga shkaqet e përmendura në paragrafin 1.

Neni 2

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose aprovimi, mund të përcaktojë territorin ose pjesët e territorit në të cilët do të zbatohet ky protokoll.

2. Nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në një datë të mëvonshme, çdo shtet mund ta zgjerojë zbatimin e këtij protokoll në çdo pjesë tjetër territori të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë pjesë territori protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me ndonjë pjesë territori të përcaktuar në një deklaratë të tillë, mund të tërhiqet ose të modifikohet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja ose modifikimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason kalimin e afatit tremujor pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

4. Një deklaratë e bërë në pajtim me këtë nen do të konsiderohet sikur të jetë bërë në pajtim me paragrafin 1 të nenit 56 të Konventës.

5. Çdo shtet që ka bërë një deklaratë në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, në një kohë të mëvonshme mund të deklarojë, në lidhje me një ose disa pjesë të territorit për të cilët bëhet deklarata, se ai pranon kompetencën e gjykatës për të marrë kërkesa nga individë, organizata joqeveritare ose grupe individësh sipas parashikimit të nenit 34 të Konventës në lidhje me nenin 1 të këtij protokoll.

Neni 3

Raporti me Konventën

Ndërmjet shteteve anëtare, dispozitat e neneve 1 dhe 2 të këtij protokoll do të konsiderohen si nënshitesë të Konventës dhe të gjitha nenet e tjera të Konventës zbatohen përkatësisht.

Neni 4

Nënshkrimi dhe ratifikimi

Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës që kanë nënshkruar Konventën. Ai duhet të ratifikohet, pranohet ose aprovohet. Një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund të ratifikojë, pranojë ose aprovojë këtë Protokoll pa ratifikuar paraprakisht ose njëkohësisht Konventën. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose aprovimi depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 5

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën dhjetë shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të respektuar protokollin në pajtim me dispozitat e nenit 4.

2. Në lidhje me çdo shtet tjetër anëtar, i cili e shpreh më vonë pëlqimin e vet për ta respektuar atë, protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të afatit tremujor pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose aprovimi.

Neni 6

Funksione për depozitimin

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
 - b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose aprovimi;
 - c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokoll në pajtim me nenet 2 dhe 5;
 - d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që ka të bëjë me protokollin.
- Si dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qënë të autorizuar si duhet, kanë nënshkruar protokollin.

Kryer në Romë, më 4 nëntor 2000, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet janë njësoj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Principatës së Andorrës
Për Qeverinë e Republikës së Austrisë, Albert Rohan
Për Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës
Për Qeverinë e Republikës së Estonisë, Marts Rask
Për Qeverinë e Republikës së Finlandës, Johanes Koskinen
Për Qeverinë e Republikës Franceze
Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë, Irakli Menagarishvili
Për Qeverinë e Republikës Italiane, Lamberto Dini
Për Qeverinë e Republikës së Latvias, Ingrida Labucka
Për Qeverinë e Principatës së Lihtenshtajnit, Andrea Willi
Për Qeverinë e Republikës së Lituanisë, Lydie Polfer
Për Qeverinë e Republikës së Portugalisë, Paula Castiliho
Për Qeverinë e Rumanisë, Mihai Razvan Ungureanu
Për Qeverinë e Federatës Ruse, Youri Tchaika
Për Qeverinë e Republikës së San Marinos, Gabriele Gatti
Për Qeverinë e Republikës Sllovake, Pal Csaky
Për Qeverinë e Ukrainës, Suzanna Stanik
Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.